



Debate të ashpra në Kuvend për dhunën ndaj emigrantëve. Braçe: Autoritetet nuk reagojnë siç duhet

“Qeveria po e shet lirë jetën e shqiptarit”

Dhuna e ushtruar ndaj shtetasve shqiptarë nga policia dhe ushtria greke është kthyer sërisht për diskutim në sallën e Kuvendit, ku nuk kanë munguar dhe debatet e ashpra midis deputetëve të opozitës dhe pozitës. Ishte deputeti PS-së, Erion Braçe, i cili gjatë diskutimit të lirë, i ka kërkuar qeverisë shqiptare të mbrojë emigrantët shqiptarë në Greqi nga policia dhe ushtria greke. “Qeveria duhet të reagojë ndaj dhunës së grekëve. Rasti më i fundit është ai i plagosjes së një emigranti nga Berati, i cili rrezikoi seriozisht jetën

ndërsa kalonte kufirin, në kërkim të një jete më të mirë”, tha ai. Braçe ka theksuar se jeta e njeriut në këtë vend po bëhet gjithnjë e më pak e rëndësishme për qeverinë dhe autoritetet që duhet të kujdesen për të. “Fati i keq është se gjatë këtyre dy javëve kemi pasur të paktën 4-5 viktima njerëzore në ditë, që humbasin jetën për një arsye apo për një tjetër. Por fati akoma edhe më i keq lidhet me atë që autoritetet zyrtare, duke filluar nga qeveria deri tek autoriteti më i fundit nuk e vrasin mendjen për këtë. Kjo po ndikon edhe në vendet fqinje,

ku jeta e shqiptarit konsiderohet e lirë”, u shpreh më tej deputeti i opozitës. Braçe ka akuzuar qeverinë se po i trajton me shumë përkëdhelje rastet e dhunës së grekëve ndaj shqiptarëve. Ai ka sjellë në kujtesë dy rastet më të fundit, atë të rrahjes së dy të rinjve shqiptarë nga policia greke dhe atë të plagosjes me armë të një të riu nga Berati. Akuzat e Braçes kanë vijuar edhe më tej ndaj qeverisë shqiptare, e cila, sipas tij, është e paaftë për t’u siguruar punësim shqiptarëve në vendin e tyre.

E.Gjura

Protestë para ambasadës greke në qytetin britanik: Karamanlis, kërkoju falje viktimave të dhunës!

Emigrantët shqiptarë akuzojnë nga Londra: Tirana reagoi dobët

NGA LONDRA MUHAMED VELIU

Emigrantët shqiptarë në Angli kanë protestuar dje para ambasadës së Greqisë në Londër për dhunën e ushtruar nga policia helene ndaj dy të miturve shqiptarë. Me pankarta në duar, ku shkruhej “Ndal racizmit” dhe “Karamalis, kërkoju falje shqiptarëve”, për dy orë ata kanë protestuar paqesisht. Protesta e shqiptarëve në Angli vjen një ditë më pas tubimit masiv të emigrantëve tanë në Greqi dy ditë më parë. Përmes një organizimi model, në pak kohë klubi londinez i lëvizjes “Mjaft” bëri të mundur mbledhjen e dhjetëra shqiptarëve në këtë protestë, e para e këtij lloji, organizuar nga shqiptarët e Anglisë. Shumë britanikë kanë ndaluar të habitur për disa momente, duke parë protestën e trallë para ambasadës greke, që ndodhet në një ndërzotat më të shtrënjta të kryeqytetit britanik.



Letra proteste për ambasadorin grek
Demonstruesit në kor dhe pa ndërprerje, gjatë të gjithë kohës kanë hedhur parulla në anglisht, si “Ksenofobia fjalë greke” etj. E gjithë protesta është ndjekur me vëmendje nga punonjësit e ambasadës, të cilët shpeshherë u afroreshin dritare për të hedhur ndonjë shikim vjedhurazi rreth asaj që

ndodhte përjashta. Policia metropolitane londineze, në kohë rekord pranoi kërkesën e klubit londinez të “Mjaft” dhe lëshoi lejen e duhur. Që nga momenti i shfaqjes së videos në “YouTube”, ku dukej shefi i policisë së stacionit të Omonias, duke keqtrajtuar dy minoronë shqiptarë, kjo ka qenë temë dite të shqiptarët e Anglisë. Tejet të indinjuar nga kjo ngjarje, shumë prej tyre, në mënyrë private i kanë dërguar letra proteste ambasadorit grek në Londër.

Një letër edhe për Karamanlis
Nëpërmjet një letre zyrtare adresuar Kryeministrit grek, Kostas Karamanlis, të firmosur nga të gjithë pjesëmarrësit e protestës, “Mjaft London Club” ka shprehur indinjatën e shqiptarëve të Britanisë së Madhe ndaj videos shokuese dhe insitucionalizimit të dhunës në strukturat shtetërore greke. Lëvizja i ka kërkuar qeverisë greke t’i kërkojë falje publikisht popullit shqiptar, dorëheqjen e ministrit të Rendit Publik, Viron Polidoras, dhe zhvillimin e një investigimi të brendshëm policor me transparencë të plotë rreth ngjarjeve brutale. Gjatë dorëzimit të letrës nga Alketa Ceci, Ralf Gjoni dhe Andi Rrugia të personellit i ambasadës, organizatorët u siguruan se kjo letër do të transmetohej nga ambasadorit të Kryeministri grek dhe se ata do të merrnin një përgjigje nga qeveria greke për shqetësimet e tyre.

LIGJI



Gjykimi i të miturve, tani me seksione të veçanta

Të miturit që kryejnë vepra penale do të gjykojnë në specializuarat gjyqarësh, që do të ngrihen në gjashtë gjykata më të mëdha të vendit. Nisma ligjore e ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për krijimin e seksioneve të veçanta në gjykata për të miturit, është dekretoar ditë më parë nga Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, dhe do të fillojë të zbatohet gjsh prej shtatorit të këtij viti.

Burime zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, bënë të ditur se, në gjykatat, ku do të krijohen kolege për gjykimin e të miturve, do të përfshihen gjyqtarë të specializuar për shqyrtimet gjyqësore ndaj kësaj kategorie. Ndërkaj, është parashikuar, që edhe sallat në këto gjykata të jenë të veçanta dhe në çdo procedurë të shoqërohen edhe me praninë e një psikologu. Sipas të njëjtave burime, krijimi i këtyre seksioneve do të shoqërohet paralelisht edhe me ngritjen e strukturave të posaçme për këtë shtresë në institucionin e prokurorisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në Polici.

Hartimi i këtij ligji vjen pas një studimi që Ministria e Drejtësisë, kreu në lidhje me proceset gjyqësore penale ndaj të miturve, ku ekspertët konstatuan se numri i çështjeve në ngarkim të tyre në vit nuk kalon më shumë se 200 çështje. Nisur nga kjo, Ministria e Drejtësisë në konsultim edhe me ekspertë të huaj që asistojnë sistemin gjyqësor shqiptar, arritën në përfundimin për të mos krijuar një gjykatë të veçantë për të miturit, pasi ajo nuk e justifikonte krijimin e saj, por të ngrihen seksione të veçanta në gjykata kryesore të vendit, çka do të jetë edhe më efkase.

Sipas të dhënave të këtij studimi, rezultoni se Gjykata e Tiranës është institucioni që ka më shumë çështje penale në ngarkim të të miturve. Ndërsa pritet zbatimi i këtij ligji në shtator, në fazën përfundimtare është edhe ndërtimi i një paraburgimi në Kavajë për të miturit. Gjithashtu, një tjetër paraburgim, sipas projektive të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, do të ngrihet në qytetin e Lezhës.

REAGIMET

Emigrantët: Tregoi se mbi gjithçka vë çështjet partiake

“Pakënaqësi dhe për ministrin Basha”

Shqiptarët në Angli, krahas indinjatës së tyre të thellë për videon, nuk e kanë pakënaqësinë për Tiranën zyrtare, në veçanti për ministrin e Jashtëm, Lulzim Basha, i cili nuk reagoi. “Protesta jonë, në fakt, duhet të kishte filluar fuqishëm nga shteti ynë amë, Shqipëria. Sidoqoftë, gjithsecili mban peshën e turpit për vetë. Qeveria shqiptare duhet të reagojë më shpejt dhe më ashpër për këtë çështje. Por siç u pa, ata u shpërngulën në Pogradec me zgjedhjet, duke treguar se mbi gjithçka vendosin çështjet partiake të tyre. Duhet falënderuar iniciativa e klubit londinez të lëvizjes “Mjaft”, që bëri të mundur realizimin e kësaj proteste dhe që për mendimin tim është një reagim i duhur”, u shpreh emigranti Andi Rrugia. Ndërsa një tjetër emigrant shqiptar, Besim Gërguri, gjithashtu, pjesëmarrës në protestë, mbledhja e shqiptarëve para ambasadës greke në Londër merr rëndësi të veçantë, pasi tregon se ngjarje të dhunshme nuk kalohen në heshtje nga shqiptarët. “Ne do të jemi gjithmonë të zgjuar, pa u kursyer të dalim në të tilla protesta sa herë të jetë e nevojshme”, tha ai. Gërguri e konsideron reagimin e zbehtë të qeverisë shqiptare si “frikë për të ngritur zërin, pasi në Greqi jetojmë me qindra mijëra shqiptarë”. Megjithatë, sipas tij, do të vijë momenti që reagimet zyrtare të Tiranës do të jenë më të ashpra dhe ky moment do të jetë atëherë kur emigrantët atje të jenë legalizuar plotësisht. “U bashkova kësaj proteste, pasi ishte e vetmja mënyrë për të ngritur zërin kundër dhunës dhe racizmit grek ndaj të rinjve shqiptarë”, thotë Olsi Vullnetari, ekspert në fushën e emigracionit. Më tej, ai shpreh se dhuna greke ndaj shqiptarëve ka 15 vjet që po ndodh, veçse fatkeqësisht, kjo dhunë po dokumentohet më së miri përmes të tilla videosh shokuese, si ajo e publikuar para pak ditësh. “Atë që kanë ndodhur më parë janë edhe më të tmerrshme e më të dhunshme. Kjo është e papranueshme të ndodhë në një vend anëtar me të drejta të plota në BE”, shprehet i indinjuar ai. Ndërsa Alketa Ceci, një aktiviste e klubit londinez të lëvizjes “Mjaft” shprehet se ngjarje të tilla nuk mund të mbeten në heshtje. “Unë jam shqiptare që jetoj në Londër. Po identiteti im nuk ka lidhje me vendndodhjen. Si shqiptare që jam, tronditem përballë pamjeve tronditëse në atë video. Ndaj vendosëm ta ngremë zërin tonë këtu në Londër. Mendoj se të njëjtin gjë duhet të bëjnë shqiptarët në çdo vend të botës që ndodhen, para faqësive greke”, kërkon ajo. Alban Bytyqi, një nga organizatorët e protestës shpjegoi se manifestimi u organizua nga me pjesëmarrjen e gjerë edhe të shoqatave të tjera në Britaninë e Madhe. M.V.

04 357 011

Balkan Alliance Medical Center

Mjekësia turke, kaq pranë

në ambientet e Spitalit Usharak, Laprakë - Tiranë